



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:074626

Datë: 15.12.2023

Numri i dokumentit: 05078404

P.nr.1424/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Penal, me gjyqtarin Ertan Sejfulla, me praktikanten Liberta Xhema, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.K., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181, paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1715/23, të datës 24.03.2023, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më datë 15.12.2023, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1715/23, të datës 24.03.2023 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari: L.K., nga babai dhe nëna, e gjinisë, i lindur më datë, me vendbanim në, Rr “.....”, në, i, ka të kryer shkollën e, i gjendjes, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: Më datë 15.02.2023, rreth orës 17:36, i pandehuri me qëllim të shkakimit të frikësimit dhe antkhit e ka kanosur të dëmtuarin Xh.Sh nga, nëpërmjet telefonit duke i dërguar “voice mesazhe” dhe duke i thënë se “*dije se kena me ta q’ motrën njëherë je kidnapu prej rrethit tem, por këtë herë këna më ta q.. motrën njëherë se 27 veta tu të lyp*” dhe në “voice mesazhin” e dërguar në datën e njëjtë, rreth orës 18:00 dhe pastaj rreth orës 22:44, ku të njëjtit i thotë: “ku

jeni jena tu ju lyp në ///////////////, kqyre orën hala jemi tu ju lyp”, dërgoma një msn: ”ku je”, me ç’rast të dëmtuarit i ka shkaktuar ndjenjën e ankthit dhe frikës,-

- me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181, paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 të KPRK, si dhe neneve 364 dhe 495, të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **200.00 (dyqind) €**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

I njëjti dënimin e shqiptuar mund të paguajë, me dy këste. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet, nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Obligohet i pandehuri që t’i paguaj shpenzimet procedurale, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30.00) €, si dhe për fondin e kompensimit të viktimave në shumën prej njëzetë (20.00) €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar Xhelal Shala nga Prishtina, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1715/23, të datës 24.03.2023, ndaj të pandehurit L.K, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181, paragrafi 1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjykata pasi shqyrtoi përmbajtjen e aktakuzës me kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor nga ana e organit të ndjekjes, gjeti se e njëjta është përpiluar në përputhje me nenin 493 të KPPRK-së, andaj erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet nga neni 495 i KPPRK-së, që në këtë çështje penale pa u mbajtur fare shqyrtimi gjyqësor të marrë vendim për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se në bazë të deklaratës së dëmtuarit – dëshmitarit dhe të pandehurit, si dhe në bazë të dokumentacionit me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Kanosja nga neni 181, paragrafi 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Gjykata vlerësoj se edhe me këtë dënim të shqiptuar do te arrihet qellim i dënimit ne vështrim te nenit 38 te KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale te kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.08/L-109.

Në bazë të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore – juridike është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.1424/23, i datës 15.12.2023

Gj y q t a r i
Ertan Sejfulla

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkëmor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.